

AUDITUESE LIGJORE (Eksperte Kontabël e Rregjistruar)

Elida MITI  
Nr liçense 201

**R A P O R T I I A U D I T U E S I T L I G J O R ( E K R )**

*PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA"*

*SHPK*



PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK

*PËRMBAJTJA*

- *Raporti i Ekspertes Kontabël të Rregjistruar*
- *Informacione të përgjithshme*
- *Realizimi i misionit, procedurat e angazhimit*
- *Verifikimi i ndryshimeve të zërave të aktiveve dhe kapitalit*
- *Konkluzione të përgjithshme*

*Bashkëlidhur Raportit:*

- *Bilanci i vitit ushtrimor 2019*
- *Vendimet e Ortakëve të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k., Nr. 1, datë 23.07.2020; Nr. 2, datë 01.05.2020; Nr.3, datë 19.10.2020*
- *Çertifikatat e pronësisë*
- *Kartelat e pasurive (shoqëruese të çertifikatave)*
- *Kontratat e shitblerjes së aktiveve*

**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË “CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA” SHPK**

**DREJTUAR: ORTAKËVE TË SHOQËRISË “CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA” SH.P.K.**

**QËLLIMI I ANGAZHIMIT:**

Në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të Vendimit nr. 3 datë 19.10.2020 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë “CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA” sh.p.k. është vendosur zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me kontribut në natyrë, nëpërmjet kapitalizimit të asetëve të blera me mjetet e shoqërisë, nga përdorimi i fitimit të mbartur nga viti 2019, pra në pronësi të vet shoqërisë.

Po me të njëjtin vendim, Unë Elida Miti, me profesion Audituese Ligjore (Eksperte Kontabel e Regjistruar) me license profesionale Nr.201, datë 04.10.2010, lëshuar nga IEKA, jam caktuar eksperte në misionin për rritjen e kapitalit të shoqërisë “CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA” SH.P.K. me kontribute në natyrë për vlerën e aktiveve materiale afatgjata të blera nga shoqëria dhe në pronësi të saj.

Unë kam realizuar angazhimin tim në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Dhënies së Sigurisë 3000.

Ky Standad kërkon që unë të planifikoj dhe të kryej procedurat në mënyrë që të arrij një nivel të arsyeshëm sigurie.

**PËRGJEGJËSIA E DREJTIMIT**

Drejtimi është përgjegjes për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë, në përputhje me kërkesat ligjore, të: deklarimeve financiare, juridike dhe të informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë së procesit të kapitalizimit të aktiveve në shoqërinë “CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA” sh.p.k.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës të ndërmarrë në kohe të gjitha veprimet e nevojshme për të njoftuar palët e interesuara për procesin e zmadhimit të kapitalit në natyrë në shoqërinë “CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA” sh.p.k.

Drejtimi ka përgjegjësinë të garantojë se nuk është i përfshirë në ndonjë proces falimentimi apo likuidimi.





PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK

PËRGJEGJËSIA E EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Përgjegjësia ime është të jap një opinion mbi sigurinë e procesit bazuar në verifikimin e dokumentacionit, procedurave e metodave të përdorura për të arritur zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kapitalizimit të aktiveve, blerë nga shoqëria, si dhe përshtatshmërinë e përdorimit të këtyre metodave.

OPINION

*Sipas Opinionit tim, pas verifikimit të dokumentacionit dhe procedurave të kapitalizimit të aktiveve materiale afatgjata tek shoqëria "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. rezulton se rritja e kapitalit të rregjistruar të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. është sipas kuadrit ligjor.*

Auditues Ligjor (EKR)

Elida MITI

Nr. License 201

Tiranë, më 17/10/2020

**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK**

**INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

**Të dhëna të përgjithshme mbi shoqërinë**

Shoqëria "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datën 01.03.2018 dhe është regjistruar në QKB në datën 05/03/2020, me kapital fillestar 15.100.000 lekë. Kapitali i shoqërisë është krijuar nga kontribute në natyrë në vlerën totale 15.000.000 lekë dhe në mjete monetare në shumën 100.000 lekë. Kapitali zotërohet nga tre ortakë në vlerat dhe përqindjet e mëposhtme:

<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Kontributi</i>		
	<i>në lekë</i>	<i>në natyrë</i>	<i>në përqindje</i>
1. Kristina Fidhi	40.000	6.000.000	40%
2. Ilir Hitaj	40.000	6.000.000	40%
3. Aurel Kallfa	20.000	3.000.000	20%

**Kapitali aktual** i shoqërisë është i pandryshuar qoftë në vlerë, 15.000.000 leke, dhe qoftë në zotërimet e kuotave.

Selia e shoqërisë është në adresën: Antigon, fshati "Asim Zeneli", Lagjja Qendër, Rruga "Sabri Shameti", Objekti Nr.147/392, Zona Kadastrale 1058, Gjirokastrë.

Shoqëria është regjistruar pranë organeve tatimore të Rrethit Gjirokastrë, me NIPT L82705601V.

**Objekti i veprimtarisë** së Shoqërisë është: Udhëtime dhe ture profesionale me kuaj, trajnime kuajsh, kalorësish. Aktivitete për klientë jo kalorës. Operator turistik. Import-Eksport të artikujve dhe mallrave që janë në funksion të qëllimit të aktivitetit të shoqërisë. Lidhje kontrata shërbimesh me operatorë të tretë, po në funksion dhe qëllim të aktivitetit të shoqërisë.

Drejtimi i shoqërisë: Shoqëria ka dy administratorë, Znj.Kristina Fidhi dhe Z.Ilir Hitaj, që janë, njëkohësisht, edhe ortakë.

**Baza Ligjore për kryerjen e këtij Angazhimi**

1. Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Ligji Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për QKB në".
3. Statuti dhe Akti i Themelimit të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k..
4. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. Nr. 1, datë 23.07.2020;Nr. 2, datë 01.05.2020; Nr.3, datë 19.10.2020
5. Kontratat e shitblerjes së aktiveve
6. Çertifikatat e pronësisë dhe Kartelat e pasurive, shoqëruese të çertifikatave:
  - 6.1. Tokë arë, sipërfaqe 1300 m<sup>2</sup>, Çertifikatë nr. 1863905, Numër pasurie 113/6, ZK 1058, Gjirokastrë, në pronësi të "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk
  - 6.2. Tokë arë, sipërfaqe 1300 m<sup>2</sup>, Çertifikatë nr. 1863549, Numër pasurie 113/7, ZK 1058, Gjirokastrë, në pronësi të "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk
  - 6.3. Tokë arë, sipërfaqe 700 m<sup>2</sup>, Çertifikatë nr. 1863712, Numër pasurie 113/8, ZK 1058, Gjirokastrë, në pronësi të "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk



PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK

**Procedurat e mia të angazhimit përfshijnë:**

- Verifikimin e llogarive analitike si dhe kontrollin e llogarive specifike parashikuar nga Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji Nr.10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar"; Ligji Nr.9228, date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- Verifikimin e vlerave dhe të dokumentacionit përkatës lidhur me aktivet që përdoren për zmadhim kapitali, bazuar në kontratat e shitblerjes, çertifikatat e pronësisë dhe kartelat rifreskuara të pronësisë në momentin e blerjes.
- Verifikimin dhe konsultimin me të dhënat e Pasqyrave Financiare të vitit 2019
- Verifikimin e situatës ekonomiko-financiare të shoqërisë para momentit të zmadhimit të kapitalit.
- Përgatitjen e raportit të audituesit (EKR-së) mbi verifikimin e procedurave për kapilizimin e aktiveve materiale afatgjata tek "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. duke rritur vlerën e kapitalit të kësaj të fundit.

**VEPRIMET KONTABËL PËR PARAQITJEN E BILANCIT FINANCIAR TË Shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k.**

Për të realizuar rritjen e Kapitalit, shoqëria "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. ka shfrytëzuar mjetet monetare të saj, duke i investuar ato në blerje aktive, tokë, në përputhje me Vendimet e Asamblesë së Ortakëve Nr. 1 dhe 2.

Për të kryer kontabilizimet e nevojshme duhet mbajtur parasysh që procesi i zmadhimit të kapitalit i referohet përdorimit të fitimit të vitit 2019, siç shprehet në vendimet e asamblesë së ortakëve, duke kaluar kështu dy faza:

- Blerja e aktiveve, si hap paraprak, në zbatim të Vendimit nr.1 të Asamblesë së Ortakëve për miratimin e PF 2019 dhe destinimin e rezultatit, ku thuhet "shoqëria nuk do të kryejë shpërndarje dividendi, por do ta përdorë atë për zgjerimin e aktivitetit të shoqërisë" dhe të Vendimit nr.2;
- Zmadhimi i kapitalit, në zbatim të Vendimit nr.3 të Asamblesë së Ortakëve, nëpërmjet kalimit të aktiveve afatgjata materiale, të blera, në kontribut në natyrë.

1. Meqënëse procesi është kryer në dy faza, edhe kontabilizimet do të ndjekin këtë rrjedhë. Bazuar në kontratat e shitblerjes, do të përdoret Llog. 211 "Aktive Afatgjata Materiale/ Toka" dhe kundërpartia e saj do të jetë llogaria 467 "Detyrime ndaj të tretëve"

Vlerat dhe të dhënat e tjera të pasurive që do të përdoren për rritje kapitali paraqiten si më poshtë :

- Tokë arë, sipërfaqe 1300 m<sup>2</sup>, Çertifikatë nr. 1863905, Numër pasurie 113/6, ZK 1058, Gjirokastrë, në pronësi të "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk, vlera 180.000 lekë;



**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK**

- Tokë arë, sipërfaqe 1300 m<sup>2</sup>, Çertifikatë nr. 1863549, Numër pasurie 113/7, ZK 1058, Gjirokastrë, në pronësi të "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk, vlera 190.000 lekë;
  - Tokë arë, sipërfaqe 700 m<sup>2</sup>, Çertifikatë nr. 1863712, Numër pasurie 113/8, ZK 1058, Gjirokastrë, në pronësi të "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk, vlera 100.000 lekë
2. Llogaria 467 "**Detyrime ndaj të tretëve**" është mbyllur me pagesat e kryera në bankën "Intesa SanPaolo Bank", të verifikuara nga ana ime si më poshtë:
- 2.1 Në datën 16.05.2020, vlera 190.000 lekë , për noterin Vangjeli Marko
  - 2.2 Në datën 24.06.2020, vlera 100.000 lekë , për noterin Ermal Aliko
  - 2.3 Në datën 18.07.2020, vlera 180.000 lekë , për noterin Ermal Aliko
- Pra kundërpartia e kësaj llogarie do të jetë llogaria 512 "**Banka**"
3. Me Vendimin nr.3 të Asamblesë së Ortakëve, aktivet e blera do të përdoren për zmadhimin e kapitalit në natyrë. Meqënëse origjina e këtyre aktiveve është investimi i kryer nga përdorimi i fitimit të mbartur nga viti 2019, llogaritë që do të preken janë Llogaria 108 "**Fitime të mbartura**", në debi, dhe Llog. 101 "**Kapitali**", në kredi.

Kapitali i shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. do të zmadhohet për vlerën totale të aseteve në shumën **470.000** (katërqind e shtatëdhjetë mijë) **leke**.

**Kapitali para kapitalizimit të aseteve**

Përpara se të analizoj vlerën e kapitalit të shoqërisë, edhe pse ky nuk është qëllimi i këtij raporti, më duhet të theksoj se në PF të vitit 2019, vlera e kapitalit nuk është paraqitur saktë, në përputhje me vlerën e deklaruar në QKB. Sipas bilancit të vitit 2019, kapitali paraqitet në shumën 100.000 lekë për vitin 2018 dhe pa asnjë vlerë për vitin 2019. Ndërkohë që vlera e deklaruar në QKB, në momentin e rregjistrimit, dhe po kështu në dokumentat e vet shoqërisë, Statut dhe Akt Themelimi, është 15.100.000 lekë.

Duke patur parasysh që kjo mungesë në paraqitje është e lidhur me faktin që pjesa kryesore e kapitalit, në vlerën 15.000.000 lekë, është kapital në natyrë, atëherë kjo pasaktësi do të ketë efekt edhe në Aktiv të bilancit, në vlerën e aktiveve afatgjata materiale. Në total, vlerat e Aktivit dhe Pasivit të bilancit do të ndryshonin në rritje me vlerën 15.000.000 lekë. Po kështu, bilanci i vitit 2019 ka paqartësi në lidhje me mbartjen e humbjes së vitit 2018.

Për të qënë korrekt me informacionin e siguruar, si nga klienti, ashtu edhe nga burime të tjera zyrtare, po paraqes më poshtë Pasqyrën e Pozicionit Financiar, siç është dorëzuar dhe, më poshtë siç e gjykoj që duhet.

Për të theksuar që, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin e bërë nga ana ime në lidhje me zmadhimin e kapitalit.



**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK**

SIÇ ISHTE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
<i>Mjete monetare</i>	703,706	381,636
<i>Te drejta te arketueshme dhe te tjera investime financiare</i>		
Instrumenta te tjera financiare		100,000
<b>Shuma</b>	<b>0</b>	<b>100,000</b>
<b>Inventare</b>		
Lende te para dhe materiale te konsumueshme	45,028	217,052
Produkte te gatshme	628,393	954,099
<b>Shuma</b>	<b>673,421</b>	<b>1,171,151</b>
<b>Shuma aktive afatshkurtra</b>	<b>1,377,127</b>	<b>1,652,787</b>
<b>Aktive afatgjata</b>		
<b>Aktive afatgjata materiale</b>		
Toka dhe ndertesa		
Makineri dhe paisje	562,500	625,000
<b>Shuma</b>	<b>562,500</b>	<b>625,000</b>
<b>Shuma aktive afatgjata</b>	<b>562,500</b>	<b>625,000</b>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>	<b>1,939,627</b>	<b>2,277,787</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	989,160	3,797,137
Te pagueshme ndaj punonjesve, kontribute dhe te tjera te ngjashme	50,639	133,050
<b>Shuma</b>	<b>1,039,799</b>	<b>3,930,187</b>
<b>Shuma e detyrimeve</b>	<b>1,039,799</b>	<b>3,930,187</b>
<b>Kapitali</b>		
Kapitali i pronarit		100,000
Fitime/(Humbje) te periudhes financiare	899,828	-1,752,400
Fitime/(Humbje) te mbartura		
<b>Shuma e Kapitalit</b>	<b>899,828</b>	<b>-1,652,400</b>
<b>TOTALI DETYRIMET DHE KAPITALI</b>	<b>1,939,627</b>	<b>2,277,787</b>



**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK**

SIÇ DUHET

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
<i>Mjete monetare</i>	703,706	381,636
<i>Te drejta te arketueshme dhe te tjera investime financiare</i>		100,000
<b>Shuma</b>	<b>0</b>	<b>100,000</b>
<b>Inventare</b>		
Lende te para dhe materiale te konsumueshme	45,028	217,052
Produkte te gatshme	628,393	954,099
<b>Shuma</b>	<b>673,421</b>	<b>1,171,151</b>
<b>Shuma aktive afatshkurtra</b>	<b>1,377,127</b>	<b>1,652,787</b>
<b>Aktive afatgjata materiale</b>		
Toka dhe ndertesa	15,000,000	15,000,000
Makineri dhe paisje	562,500	625,000
<b>Shuma</b>	<b>15,562,500</b>	<b>15,625,000</b>
<b>Shuma aktive afatgjata</b>	<b>15,562,500</b>	<b>15,625,000</b>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>	<b>16,939,627</b>	<b>17,277,787</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	2,641,560	3,797,137
Te pagueshme ndaj punonjesve, kontribute dhe te tjera te ngjashme	50,639	133,050
<b>Shuma</b>	<b>2,692,199</b>	<b>3,930,187</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
<b>Shuma e detyrimeve</b>	<b>2,692,199</b>	<b>3,930,187</b>
<b>Kapitali</b>		
Kapitali i pronarit	15,100,000	15,100,000
Fitime/(Humbje) te periudhes financiare	899,828	-1,752,400
Fitime/(Humbje) te mbartura	-1,752,400	
<b>Shuma e Kapitalit</b>	<b>14,247,428</b>	<b>13,347,600</b>
<b>TOTALI DETYRIMET DHE KAPITALI</b>	<b>16,939,627</b>	<b>17,277,787</b>

Kapitali aktual para zmadhimit , i regjistruar në QKB dhe i pasqyruar në dokumentat e shoqërisë është 15.100.000 lekë.



**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK**

**Kapitali pas kalimit të aseteve nga ortaku në shoqëri**

Vetëm për efekt të veprimeve kontabël që lidhen me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k., në momentin e kapitalizimit të aktiveve, Pasqyra e Pozicionit Financiar do të ndryshojë si më poshtë:

<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>Pas zmadhimit</b>	<b>Para zmadhimit</b>
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
<i>Mjete monetare</i>	233,706	703,706
<i>Te drejta te arketueshme dhe te tjera investime financiare</i>		
Shuma	0	0
<i>Inventare</i>		
Lende te para dhe materiale te konsumueshme	45,028	45,028
Produkte te gatshme	628,393	628,393
Shuma	673,421	673,421
<b>Shuma aktive afatshkurtra</b>	<b>907,127</b>	<b>1,377,127</b>
<b>Aktive afatgjata</b>		
<i>Aktive afatgjata materiale</i>		
Toka dhe ndertesa	15,470,000	15,000,000
Makineri dhe paisje	562,500	562,500
Shuma	16,032,500	15,562,500
<b>Shuma aktive afatgjata</b>	<b>16,032,500</b>	<b>15,562,500</b>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>	<b>16,939,627</b>	<b>16,939,627</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<i>Detyrime afatshkurtra</i>		
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	2,641,560	2,641,560
Te pagueshme ndaj punonjesve, kontribute dhe te tjera te ngjashme	50,639	50,639
Shuma	2,692,199	2,692,199
<i>Detyrime afatgjata</i>		
<b>Shuma e detyrimeve</b>	<b>2,692,199</b>	<b>2,692,199</b>
<i>Kapitali</i>		
Kapitali i pronarit	15,570,000	15,100,000
Fitime/(Humbje) te periudhes financiare		899,828
Fitime/(Humbje) te mbartura	-1,322,572	-1,752,400
<b>Shuma e Kapitalit</b>	<b>14,247,428</b>	<b>14,247,428</b>
<b>TOTALI DETYRIMET DHE KAPITALI</b>	<b>16,939,627</b>	<b>16,939,627</b>



**PËR ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" SHPK**

Ndryshimet si më sipër në kapital do të pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020 të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" shpk. Zërat e bilancit që ndikohen nga ky veprim janë: Kapitali, Mjetet monetare dhe Aktivet Afatgjata Materiale.

**Konkluzione përfundimtare**

Pas verifikimit të të gjithë procesit dhe dokumentacionit të përshkruar më sipër mbi bazën e të cilëve është përcaktuar vlera e kapitalizimit të aktiveve materiale afatgjata tek shoqëria "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k., paraqes opinionin tim si më poshtë:

1. Vendimi i Ortakëve të shoqërisë "CARAVAN HORSE RIDING ALBANIA" sh.p.k. është i drejtë dhe i bazuar në ligj.
2. Kapitali i shoqërisë nga 15.100.000 lekë, pas zmadhimit, shkon në 15.570.000 lekë, i zotëruar nga ortakët, secili nga nje kuotë, në vlerat e mëposhtme, pa ndryshuar përqindjet e zotërimit:

<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Kontributi</i>		
	<i>në lekë</i>	<i>në natyrë</i>	<i>në përqindje</i>
1. Kristina Fidhi	40.000	6.188.000	40%
2. Ilir Hitaj	40.000	6.188.000	40%
3. Aurel Kallfa	20.000	3.094.000	20%
	<b>100.000</b>	<b>15.470.000</b>	<b>100%</b>

3. Kapitali përbëhet nga kapital në natyrë në shumën 15.470.000 lekë dhe kapital në para në shumën 100.000 lekë.

Raporti i paraqitur prej meje mund të miratohet nga ana e shoqërisë dhe të kalohet për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

AUDITUES LIGJOR

Elida MITI Nr. License



Tiranë, më 17/10/2020